




Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

alter | instituti
habitus | për studime
në shoqëri
dhe kulturë

KU JANË PARATË PËR TË DREJTAT E GRAVE?

RAST STUDIMI NË KOSOVË



Për Hulumtimin

- € Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës në partneritet me Alter Habitus – Institutin për Studime në Shoqëri dhe Kulturë (AH)
- € Ka përdorur metodologjinë e AWID “Ku janë paratë për të drejtat e grave?”, dhe ka adoptuar në kontekstin e Kosovës
- € Është përpjekur të kontribuojë në iniciativën më të gjerë hulumtuese të AWID-it përmes një rasti studimor për Kosovën.
- € Shikoj mundësitë e bashkëpunimit në mes të organizatave të grave dhe donatorëve në krijimin e strategjive të përbashkëta për mobilizimin e resurseve dhe mekanizmave të financimit për organizatat e grave.

Pyetjet e hulumtimit

- € Cila është rëndësia e mbështetjes së organizatave të grave në proceset e ndryshimeve sociale;
- € Cilat janë ndryshimet përgjatë procesve të ndryshme historike që kanë ndikuar në trendet e donatorëve dhe situatën financiare të organizatave të grave?
- € Sa janë të qëndrueshme financiarisht organizatat e grave?
- € Cilat janë trendet e brendshme dhe të jashtme që ndikojnë në vendimin e donatorëve për të mbështetur organizatat e grave apo lëvizjet e grave?
- € Cilat janë mundësitë e bashkëpunimit në mes të organizatave të grave dhe donatorëve në krijimin e strategjive të përbashkëta për mobilizimin e resurseve dhe mekanizmave të financimit për organizatat e grave?

Metodat e hulumtimit

- € Pyetësor për 98 Organizata të grave
 - € Nga 103 të njohura për ne (89% shkalla e përgjigjes)
 - € Të gjitha etnicitetet
 - € Nga shumica e komunave
- € Intervista me 34 donator
- € Hulumtim literature:
 - € Raportet e auditimit dhe raportet vjetore të organizatave
 - € ëeb faqet e donatorëve
 - € Informacione tjera online

Definicionet

- € Organizatat e Grave: organizata që udhëhiqen nga gratë të cilat ndërrmarrin apo jo përpjekje për të avanucuar të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.
- € Organizatat e të drejtave të grave: fokusohen në avancimin e të drejtave të grave dhe transformimin e normave gjinore në praktikë.
- € Donatorët: cdo organizatë jo qeveritare, qeveritare, jo fitim prurëse, apo fitim prurëse, biznes apo entitet që ka dhënë fonde në Kosovë.

Të metat – apo limitet e hulumtimit

- € Periudhë e shkurtër
- € Refuzimet: koha, “konfidencialiteti”, situata politike
 - € 5 organizata të grave në Mitrovicë veriore nuk janë përgjigjur pyetësorit për shkak të sigurisë
- € Resultatet: “zbrastësi” në të dhënat, dhe jo representim i mirë i të gjitha fondeve për të gjitha sektorët.
- € Mos përputhje mes të dhënave nga donatorët dhe të dhënave nga OJQ-të për financimet e njëjta
- € Me gjithë zbrastësitë që ka, mendojmë që hulumtimi sjell të gjetura të rëndësishme dhe të reja.

Validiteti

- € Vlerësim nga pjesëmarrësit
 - € Këto janë rezultatet preliminare, prandaj po kërkojm kontributin tuaj në rast të ndonjë gabimi si dhe rekomandime tjera
 - € Rekomandimet sot do të jenë pjesë e raportit final, që do të bëhet në fund të shtatorit

Përmbatja e Raportit


- € Rëndësia e mbështetjes së organizatave të grave për proceset shoqërore, dhe për më shumë financimi për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore
- € Trendet dhe ndryshimi i tyre changes përgjatë viteve 2000 dhe 2013
- € Stabiliteti financiar i organizatave të grave
- € Trendet që ndikojn në vendimet e donatorëve për të financuar organizatat e grave
- € Mundësitë për bashkëpunim në mes organizatave të grave dhe donatorët për të krijuar strategji për resurse mobilizuese dhe mekanizma për të financuar organizatat e grave.

Të gjeturat

- € Organizatat e grave luajn një rol të rëndësishëm në:
 - € Avokim: të mbajn qeveritë përgjegjëse për politikat e zhvilluara
 - € Avancimi I të drejtave të grave si të drejta të njeriut
 - € Ngritja e vetëdijës
 - € Ofrim të shërbimeve, sidomos për grupet e marginalizuara (në mungesë të shërbimeve nga shteti)
- € Këto aktivitete kërkojnë përkushtim dhe financim


Të gjeturat

€ Pyetëtorët tregojn rënje në përgjithësi të financimit në mes vitit 2000 dhe 2013, me një rritje të vogël në 2011



Të gjeturat: Sektorët

Totali i fondeve të njohura për OJQ-te e grave në miliona, sipas ceshtjeve, 2000 - 2014



Të gjeturat

- € Përveq organizatave të vendosura në Prishtinë, shumica e organizatave të grave kanë vështirësi në sigurimin e fondeve të mjaftueshme për të punuar në çështje të cilat ato kan identifikuar
- € 55% të organizatave të grave nuk kanë pranuar asnjë lloj financimi në 2011 në çështjet të cilat kanë pas prioritet

Të gjeturat

- € Më pak se 10% e organizatave të grave marrin të ardhura nga individët, asetet, pagesat e anëtarësisë ose nga aktivitetet që sjellin të hyra
- € Varësi e madhe nga fondet ndërkombëtare
- € Mungesë e diversifikimit të resurseve të financimit
- € 71% të organizatave kanë zvogëluar stafin, zvogëluar aktivitetet ose kanë punuar në mënyrë vullnetare për periudha të gjata kohore
- € 36% kanë qenë në rrezik që të mbyllin zyrat e tyre e disa prej tyre i kanë mbyllur ato kohë pas kohe.
 - € Kjo ka pasur pasoja të rënda për grupet e marginalizuara, siç janë personat që kanë pësuar nga dhuna me baza gjinore.

Të gjeturat

- € Prej 34 donatorëve që kanë marrë pjesë në hulumtim, vetëm pesë kishin financuar organizatat e grave.
- € Disa i vënë fondet në dispozicion përmes aplikimeve të rregullta (p.sh., për grante ose kontrata).
 - € Organizatat e grave shpesh duhet të konkurrojnë me organizata ose bizneset e tjera.
- € 77% e organizatave të grave nuk kanë marrë kurrë fonde institucionale.

Konkluzionet

- € Donatorët janë të prirë të pajtohen se financimi i barazisë gjinore është i rëndësishëm; pyetja është se si. Disa donatorë janë të angazhuar në zhvillimin e strategjive të reja në këtë aspekt.
- € Përderisa financimi për barazinë gjinore duket se është rritur në mes të viteve 2008 dhe 2011, kjo nuk është përkthyer gjithmonë në financim të organizatave të grave
 - € Vetëm përafërsisht 35% e gjithë financimit që donatorët e kanë “ndarë” për barazi gjinore ose për të drejtat e grave në Kosovë u ka shkuar organizatave të grave.
 - € Ekziston një mbështetje substanciale për organizatat e fuqishme që kryesisht janë me seli në Prishtinë

Konkluzionet

- € Rrezikshmëri sa i përket qëndrueshmërisë së organizatave të grave:
 - Ndryshimi i statusit politik të Kosovës
 - largimi i donatorëve,
 - shpërndarja gjithnjë e më e madhe e ndihmës bilaterale përmes Qeverisë së Kosovës (krahasuar me shpërndarjen përmes shoqërisë civile)
 - “privatizimi” i asistencës zhvillimore
 - mbështetja afatshkurtër e bazuar vetëm në projekte
- € Mbështetja e pamjaftueshme thelbësore nga burime joqeveritare në mënyrë të veçantë e rrezikon aftësinë e organizatave avokuese për t’i mbajtur zyrtarët përgjegjës; apo
- € të sjell ndryshime të reja shoqërore dhe të politikave drejt avancimit të barazisë gjinore dhe të drejtave të grave

Konkluzionet

- € Mbledhja e të dhënave mbetet e dobët tek të gjithë akterët
- € Donatorët nuk janë të konsistent në raportimin dhe buxhetimin e ndjeshëm gjinor (d.m.th, përcjellja se sa para shkojnë për avancimin e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave)
- € Shumica e organizatave të grave janë të dobëta në përcjelljen dhe raportimin e ndikimit afatgjatë të atyre kontributeve financiare

Rekomandimet

Përmirësimi i koordinimit në mes të institucioneve qeveritare, organizatave të grave dhe donatorëve

- € Themelimi i një organi për koordinimin e donatorëve nga Ministria e Integrimit Evropian dhe takimi koordinues i donatorëve i organizuar nga kjo Ministri bashkë me Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGJ) kanë qenë hapa fillestarë pozitiv.
- € Ministria dhe ABGJ të organizojn takimet koordinuese tremujore, përfshirë edhe komponentin e caktimit të strategjive, me qëllim të përmirësimit të koordinimit dhe mbështetjes më strategjike të iniciativave për barazi gjinore.

Rekomandimet – vazhdim

- Përfshirja e përfaqësuesve të organizatave të grave.
- ABGJ mund të bashkëpunojë me gratë udhëheqëse nga politika dhe shoqëria civile për të identifikuar fushat kyçe që kanë nevojë për përkrahje para takimeve të donatorëve
- Në mënyrë më specifike, kërkesa specifike për financim të koordinuara me qeverinë dhe shoqërinë civile si pjesë e një strategjie më të gjerë qeveritare.

Rekomandimet - vazhdim

Përmirësimi i koordinimit në mes të institucioneve qeveritare, organizatave të grave dhe donatorëve

- € Për përmirësimin e pronësisë vendore dhe qëndrueshmërisë, Grupit për Siguri dhe Çështje Gjinore (GSCÇGJ) e udhëhequr nga ABGJ në konsultim me MIE.
- € Përtej sigurisë, GSCÇGJ mund të zgjerohet për tu marrë edhe me çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me barazinë gjinore
- € Përveq koordinimit, nëngrupet mund të fokusohen në çështje (si p.sh dhuna seksuale dhe dhuna në familje).
- € Konsolidimi me donatorët për një shfrytëzim më efikas të kohës, duke kaluar nga shkëmbimi i informatave në caktimin e strategjive dhe koordinimin më konkret.

Rekomandimet

Për organizatat e grave

- € Ndikojeni agjendën në vend se të reagoni ndaj saj:
avokoni më shumë si tek qeveria ashtu edhe tek donatorët, duke ofruar dëshmi se pse financimi i organizatave të grave është veprim strategjik.
 - Ofroni ekspertizën tuaj tek donatorët për planifikimet strategjike afat mesme

Rekomandimet

- € Krijoni raporte pozitive me Ministrinë e Integritimit Evropian, përgjegjëse për mbikëqyrjen e ndihmës për zhvillim (ODA), dhe avokate për mbështetjen e vazhdueshme të barazisë gjinore, të drejtave të grave, e në mënyrë specifike, të organizatave të grave.

Rekomandimet

- € Forconi ekspertizën tuaj në një ose dy fusha kryesore, në mënyrë që atë ekspertizë t'ia ofroni qeverisë dhe/ose donatorëve. Kjo mund t'i sjell organizatës suaj resurse shtesë, pasi që ju mund të kontraktoheni si ekspert në ofrimin e shërbimeve të tilla.

Rekomandimet

- € Demonstroni ndikimin: dokumentoni më mirë rezultatet dhe efektet e punës tuaj Informoni donatorët dhe përfituesit tuaj për rezultatet pozitive dhe efektin që këto rezultate kanë pasur.
 - Siguroni transparencë dhe llogaridhënie më të madhe, përfshirë edhe duke publikuar raportin vjetor me informata për programet, rezultatet, ndikimin dhe financat tuaja.
 - Nëse nuk keni fonde, ofroni informacione përmes rrjeteve sociale, si përmes Facebook.

Rekomandimet

- € Bashkëpunoni më shumë me qasje kolektive:
organizatat mund të bashkëpunojnë për të pasur ndikim më të madh në strategjitë e financimit të donatorëve dhe në mobilizimin e resurseve.
- € Punoni më shumë me meshkuj përfshirë edhe ata
në agjencitë qeveritare dhe OJQ-të e tjera, drejt qëllimeve të përbashkëta
 - Sigurohuni që gratë të jenë pjesë e proceseve më të mëdha në të gjitha çështjet (p.sh., në zhvillimin ekonomik).
 - Aplikoni në partnership tek donatorët.

Rekomandimet

- € Ndërmerrni veprimet pasuese pasi të keni filluar të punoni në një çështje
 - Mbështetje shtesë në avokim, monitorim ose zbatim.
- € Sigurohuni që të jeni në sektorin e duhur: Disa organizata të grave duhet të mendojnë daljen në sektorin privat për shkak të natyrës së punës së tyre
 - Nëse krijoni të hyra, keni qarkullim të parasë dhe krijoni profit, ju mund t'i takoni sektorin privat
 - Qeveria dhe donatorët po ashtu ofrojnë financim për bizneset që udhëhiqen nga gratë

Rekomandimet

Për donatorët ndërkombëtarë

- € Përfshini kritere afirmative që inkurajojnë organizatat e udhëhequra nga gratë të aplikojnë në thirrjet për paraqitjen e aplikacioneve, ofertave ose propozimeve.
- € Zhvilloni sisteme më të mira dhe tregues specifik që u përgjigjen gjinive për të përcjellë shpenzimet përgjatë kohës.
 - Përfshirja gjinore duhet të përmbajë edhe ndarjet e buxhetit adekuat për çështje gjinore.
 - Instaloni sisteme financiare që kanë tregues për përcjelljen e shpenzimeve nga perspektiva gjinore
- € Rriteni transparencën për shpenzimet duke publikuar raporte të thjeshta vjetore dhe duke i vënë në dispozicion në internet, të cilat përfshijnë të dhëna për shpenzimet të ndara sipas gjinive.

Rekomandimet

- € Drejt një qasjeje bazuar në nevoja, diskutoni programet e reja dhe/ose planet strategjike përmes emailit dhe grupeve të fokusuara me përfaqësuesit e organizatave të udhëhequra nga gratë në mënyrë që të mblidhen informata kthyesë për projektplanet/strategjitë nga perspektiva gjinore.
- € Siguroni që përfshirja gjinore ose temat transversale të merren seriozisht
 - përfshirë edhe involvimin e ekspertëve gjinorë vendorë në vlerësimin se sa janë përfshirë në mënyrë të mjaftueshme gjinitë në propozimet (planifikimet) dhe projektet (gjatë vlerësimeve).

Rekomandimet

Për qeverinë

- € Bashkëpunimi me shoqërinë civile është i rëndësishëm për demokracinë, e veçanërisht organizatat e grave mund të sjellin informata të rëndësishme në tavolinë të cilat do të informonin politik-bërjen dhe do të lehtësonin zbatimin e legjislacionit ekzistues.
- € Ministria e Integrimit Evropian dhe ABGJ duhet të marrin rolin udhëheqës në organizimin e takimeve tremujore për koordinimin e donatorëve, si dhe takimeve për tema specifike për të diskutuar bashkëpunimin në nivel më strategjik.
- € Në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi Gjinore si dhe planeve të tjera, ndani resurse për përfshirjen e organizatave të grave si konsulente, ofruese të shërbimeve, eksperte dhe vlerësuese, sipas nevojës.